

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A.F., R.K., A.B., S.H., dhe E.C., të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson me autorizim R.K., avokat nga Prizreni, kundër të paditurve O.G., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson R.B., avokat nga Prizreni, B.B. dhe M.B., komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson me autorizim I.M., avokat nga Prizreni, për vërtetimit e së drejtës së kalimit (servitutit), përkitazi me revizionin e paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2121/2015 datë 21.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.2.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2121/2015 datë 21.9.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2121/2015 datë 21.9.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prizren, C.nr.332/2014 datë 21.7.2014, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve që të vërtetohet e drejta e kalimit të rrugës (servitutit) në favor të ngastrave kadastrorë: nr.1902/5, me sipërfaqe prej 308 m², nr. 1902/7, me sipërfaqe prej 500 m², nr. 1902/3, me sipërfaqe prej 321 m², nr. 1902/4, me sipërfaqe prej 300 m², nr. 1902/6, me sipërfaqe prej 500 m², z.k. ..., përmes (në ngarkim) ngastrave kadastrorë nr.1902/9, nr. 1902/10, nr. 1902/11, nr. 1902/12, nr. 1902/13 dhe nr.1902/14, pasuri e të paditurit O.G., ndërsa kufijtë - gjerësia dhe gjatësia e rrugës, sipas skicës së ekspertit, të përcaktohen nga gjykata dhe t'i urdhërohet Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës që këtë fakt ta regjistrojë në regjistrin e paluajtshmërive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar propozimi për marrjen e masës së sigurisë që të urdhërohet Shërbimi për legalizimin e kontratave pranë Gjykatës Komunale Prizren që të mos bëjë vërtetimin e kontratës, me të cilën do të ndryshohej gjendja në ngastrat kadastrorë nr.1902/9, nr.1902/10, nr.1902/11, nr.1902/12, nr.1902/13 dhe nr.1902/14, pasuri të të paditurit O.G., dhe ngastrën kadastrorë nr.1902/1, pasuri e të paditurve B. dhe M.B., gjer në përfundimin me formë të prerë të kësaj procedure. Me pjesën III të dispozitivit janë obliguar paditësit që të paditurit të parë t'ia kompensojnë në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës në shumën prej

1.251 €, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marrë formë të prerë, kurse të paditurit të dytë dhe të paditurit të tretë shumën prej 450 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit A.F., R.K, A. B., S. H. dhe E. C., me kohë kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet si e bazuar ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paluajtshmëritë - pasuria e favorizuar evidencohen në emër të paditësve dhe këto: ngastra kadastrore nr. 1902/5, me sipërfaqe prej 308 m² në emër të A. F.; ngastra kadastrore 1902/7 me sipërfaqe prej 500 m² në emër të K. R.; ngastra kadastrore nr. 1902/3, me sipërfaqe prej 321 m² në emër të A. B.; ngastra kadastrore nr. 1902/4, me sipërfaqe prej 300 m² në emër të S. H.; ngastra kadastrore nr. 1902/6, me sipërfaqe prej 500 m² në emër të E. C., kurse ngastrat kadastrore nr. 1902/9, 1902/10, 1902/11, 1902/12, 1902/12 dhe 1902/14 janë pasuri e të paditurit të parë O. G. Me aktgjykimin C.nr.58/2007 datë 15.10.2008 është vërtetuar se sipërfaqja prej 2.74 ari në anën veriperëndimore të ngastrës kadastrore nr. 1902/9 me gjerësi 4.25 m dhe gjatësi të përgjithshme 128.5 m, në drejtimin juglindje gjer te vija kufitare në mes të këtyre dy ngastrave janë pjesë përbërëse e ngastrave të të paditurit të parë.

Paditësit kanë kërkuar me padi që të vërtetohet e drejta e kalimit të rrugës (servitutit) përmes (në ngarkim) të ngastrave kadastrore - pasuri e të paditurit O. G., ndërsa gjerësinë dhe gjatësinë e rrugës ta përcaktojë gjykata, sipas skicës së ekspertit, si dhe kanë kërkuar që kjo e drejtë të regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parashikuara nga neni 253 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, që të mundur të krijohet e drejta reale e servitutit, sepse mes pronarëve të pasurive të privilegjuara dhe pronarëve të pasurisë shërbyese nuk është lidhur kontrata e parashikuar nga ky Ligj, me të cilën do të vendosej servituti; nuk ekziston vendimi i organit shtetëror për konstituimin e së drejtës së servitutit; nuk ka kaluar afati prej 20 vjetësh që kjo e drejtë të mund të fitohet me parashkrim fitues, siç parashikon neni 54 i Ligjit për Bazat e Marrëdhënieve Pronësore-Juridike, të cilit i referohet pala paditëse, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të vet.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, i ka aprovuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, prandaj i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e paditësve A. F. dhe E. C., duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta, pasi kanë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt edhe dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë janë dhënë arsye për faktet relevante, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Pretendimin e cekur në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse nuk bazohen mbi faktet e vërtetuara me prova dhe nuk përmbajnë arsye për faktet e vërtetuara dhe ato të pavërtetuara, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, ngase, pretendimi se paditësit për më shumë se 20 vjet kanë ushtruar me mirëbesim dhe pa shkoputje të drejtën e servitutit real, është parashtruar nga paditësit në procedurën e zhvilluar para gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të së dytës, të cilat për kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me të, prandaj nuk ka nevojë të përsëriten këtu edhe njëherë. Edhe kjo Gjykatë mbështet konstatimin e gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë e të bazuar në ligj, sipas të cilit paditësit nuk e kanë argumentuar përmbushjen e të gjitha kushteve të nevojshme për parashkrimin fitues dhe nuk kanë vënë në dukje që vërtetimi i këtij servituti të jetë i nevojshëm që paditësit të kenë qasje në pronat e veta, ngase, sipas ekspertizës së ekspertit dhe plotësimit të ekspertizës, datë 15.7.2014, është vërtetuar se paditësit rrugën e kanë shfrytëzuar përmes tokës së huaj - këtu të paditurit të parë, kurse ngastrat e veta i kanë zgjeruar në kurriz të saj, kështu që në mënyrë të padrejtë do ta ngarkonin ngastrën e të paditurit të parë, siç kanë vlerësuar me të drejtë edhe gjykatat e instancave më të ulëta, kur kërkesëpadinë e paditësve e kanë refuzuar si të pabazuar. Për këto arsye, pretendimin e revizionit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale kjo Gjykatë e vlerësoi si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të revizionit lidhur me parashkrimin fitues për fitimin e të drejtës reale të servitutit, se paditësit nuk kanë rrugë për kalim, por gjeti se ato përbëjnë vetëm një përsëritje të asaj që ka qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatave të instancave më të ulëta, të cilat lidhur me to kanë dhënë arsye të mjaftueshme e të bazuara në ligj.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Rev.nr.336/2015 datë 4.2.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku